

**V E N D I M**  
**Nr. 422, datë 12.9.2002**

**PËR RUAJTJEN DHE SHOQËRIMIN E PERSONALITETEVE TË LARTA  
SHTETËRORE**

*(Ndryshuar me VKM nr. 310, datë 14.5.2004)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7602, datë 9.9.1992 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Presidentit të Republikës dhe Kryeministrit u ruhet banesa ose rezidenca ku ndodhen dhe u bëhen ruajtja dhe shoqërimi me grup shoqërimi, me tri makina.
2. Kryetarit të Kuvendit i ruhet banesa ose rezidenca ku ndodhet dhe i bëhen ruajtja dhe shoqërimi me grup shoqërimi, me dy makina.
3. Zëvendëskryeministrit, Ministrit të Rendit Publik, Prokurorit të Përgjithshëm u ruhet banesa dhe u bëhen ruajtja dhe shoqërimi me grup shoqërimi, me një makinë.
4. Ministrave, Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, Kryetarit të Gjykatës së Lartë, Drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror, Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Kryetarit të Bashkisë së Tiranës u bëhet ruajtja e afërt fizike, me shoqërues personal.
5. Presidentit të Republikës i ruhet banesa ose rezidenca ku ndodhet dhe i bëhet ruajtja e afërt fizike me shoqërues personal, edhe 4 vjet pas lirimit të tij nga funksioni, ndërsa Kryeministrit dhe Kryetarit të Kuvendit edhe 2 vjet pas lirimit nga funksioni.
6. *Shfuqizuar.*
7. Automjetet që përdoren për ruajtjen dhe shoqërimin e personaliteteve, të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij vendimi, të vihen në dispozicion nga institucionet përkatëse, që ata kanë drejtuar.
8. Ministri i Rendit Publik, në varësi të të dhënave dhe gjendjes që paraqitet për kryerjen e shërbimit, ka të drejtë të përforcojë shërbimet për ruajtjen dhe shoqërimin e personaliteteve dhe ruajtjen e banesave të tyre.
9. Struktura dhe organika e nevojshme për ruajtjen dhe shoqërimin e personaliteteve dhe ruajtjen e banesave ose rezidencave të tyre, sipas këtij vendimi, si dhe kriteret e përzgjedhjes së efektivave që ngarkohen me këtë detyrë miratohen nga Ministri i Rendit Publik. Kohëzgjatja në shërbim e efektivave, në të njëjtin grup shoqërimi të personaliteteve të larta shtetërore, të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij vendimi, të jetë 18 muaj.
10. Pikat 1, 2, 3, 5, 6 dhe 7 të vendimit nr.76, datë 11.2.1999 “Për ruajtjen dhe shoqërimin e personaliteteve të larta shtetërore dhe trajtimin me pagë të efektivave të këtyre shërbimeve” shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**